



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevci, Nr. 8, 10000 Prishtinë
info@pak-ks.org – www.pak-ks.org

KOMUNIKATË PËR MEDIA

12 Maj, 2010

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT SHPLL REZULTATET E VALËS 43 TË PRIVATIZIMIT

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) sot në ceremoninë e hapjes së ofertave të valës 43 të privatizimit, shpalli ofertuesit e përkohshëm, fitues të Ndërmarrjeve të Reja të tenderuar përmes metodës së Spin-off-it të Rregullt.

Gjithsej 16 Ndërmarrje të Reja ishin në dispozicion për shitje.

Ofertat u pranuan në zyrat qendrore të AKP-së në Prishtinë nga ora 10:00 deri në ora 12:00.

Ceremonia e hapjes së ofertave dhe publikimi i rezultateve u zhvillua në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, nga ora 13:00 deri në ora 14:00

Ofertat janë hapur dhe rezultatet janë shpallur në mënyrë transparente, para përfaqësuesve të medieve dhe investitorëve të pranishëm.

Gjithsej janë pranuar 34 oferta.

Vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte €6,333,425.

Agjencia Kosovare e Privatizimit tani është duke punuar që të përfundoj të gjitha shitjet, në pritje të vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Agjencia, deri më 30 Prill të këtij viti ka privatizuar 576 ndërmarrje të reja, prej të cilave 552 janë privatizuar përmes metodës së Spin Off-it të Rregullt, ndërsa 24 prej tyre janë privatizuar përmes metodës së Spin Off-it Special. Nga privatizimi i

këtyre ndërmarrjeve shoqërore në Fondin e Privatizimit janë akumuluar mbi 460 milionë Euro (€464,169,611).

FUND

Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni Znj. Arta Gosalci në
038 500 400 lokali 1110 apo në arta.gosalci@pak-ks.org